

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                       |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Nga Hysni Gurra - Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?                                                                                                             |
| ADRESA  | <a href="https://www.syri.net/politike/919554/epitafi-i-frikes-apo-frika-e-epitafit/">https://www.syri.net/politike/919554/epitafi-i-frikes-apo-frika-e-epitafit/</a> |
| BURIMI  | syri.net                                                                                                                                                              |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 27 shtator 2026, 17:53:18 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 17:44:01 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | f0660d871f5b2406c406641129164839848f1f091bd9076ef0f3f808516bedfa |
| TEKSTI     | b788416cb265090519806a476106d09ff8497675228e857a173ccc6fe307ffbe |
| PAMJA      | 9ddbda3cd40c590f650b5d2653ff5fb1a0d5c5188807d089050f5b671ace6408 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | a93058de8f7980521b24af2fb560eec7730e0236501b98f9b9f35ab4fc2ec39d                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a93058de8f7980521b24af2fb560eec7730e0236501b98f9b9f35ab4fc2ec39d>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





ÇIM PEÇA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



## më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më

'Asnjë hap pas' / Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë Hysenit?

Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?

Berisha: Vlorë Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan

Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



## Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?

19:44, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Hysni Gurra

Edi Rama njoftoi nga New Yorku se me të mbërritur në Shqipëri do të mbante një konferencë emergjente me gazetarët në aeroportin "Nënë Tereza".

Hamendësimet dhe aludimet vërshuan në gjithë format e fantazisë së secilit.

Por Edi Rama nuk zhgënjeu, erdhi, anuloi takimin me gazetarët dhe nxori një video-mesazh të regjistruar ku shpalosi edhe njëherë frikërat që qarkullojnë në një mendje diabolike si e tija, frikëra që si rrallë herë gurguleja e fjalëve nuk mundi as t'i fshehtë, as t'i zbusë.

## Qëllimi dhe frikërat

Qëllimi i parë i këtij monologut të vogël në Rinas ishte të fshehtë dështimin septakolar të një monologu të madh që mbajti në sallën e boshatisur të OKB-së.

Vizita e tij disa ditore në Shtetet e Bashkuara ishte një dështim që nuk mund ta mbulojë dot me monologun e Rinasit. Ndërsa kryeministri i Maqedonisë së Veriut takoi Sekretarin Amerikan të Shtetit, Marco Rubion dhe disa kongresmenë e zyrtarë të lartë të administratës Trump, Edi Rama takoi vetëm Pjerin Ndreun dhe Taulant Ballën.

Turpërim të tillë Shqipëria nga përfaqësimet e deritanishme në OKB nuk ka patur ndonjëherë më parë.

Qëllimi tjetër ishte të bënte hasha atë që nuk bëhet dot. U përpoq të minimizojë skandalin më të madh të ndodhur ndonjëherë më parë në vend, atë të përdorimit të Shërbimit Informativ Shtetëror për llogari të grupeve kriminale. Vlorë dhe Gysi janë as më pak e as më shumë se Edi Rama vetë.

U përpoq dëshpërimisht, duke turfulluar, të nxirte kokën nga llumi i korrupsionit ku është zhytur vetë dhe gjithë enturazhi i tij i Rilindjes.

Ai e di shumë mirë se shqiptarët tashmë e kanë të qartë se pas miliarda eurove të

korupsionit në Shqipëri qëndron një emër i përveçëm që ka patur dijeni, Edi Rama. Dardhat e pleshkët nuk i ha më kush.

-Shqiptarët e dinë tashmë se pas inceneratorit të Tiranës qëndron Edi Rama dhe Erion Veliaj.

-Shqiptarët e dinë se pas EcoParku është Edi Rama

-Shqiptarët e dinë se kanabizimi i Shqipërisë është bërë me dijeni të Edi Ramës.

Edi Rama e di se shqiptarët tashmë nuk e hanë më gugullimën e fjalëve të tij sepse e dinë që koncesionet dhe përdorimi i pasurisë publike, çështja e Charles McGonigal, kontrolli dhe ndërsimi i drejtësisë atje ku do ai janë të gjitha me dijeni të ti.

Edi Rama e di se sot që flasim Porti i Durrësit është një "zonë e lirë" ekonomike për "hamejtë". Ai e di shumë mirë se drejtorët e portit dhe policët kufitarë janë shërbëtorë të "hamenjve" të portit.

#### **Frikërat**

Edi Rama e di se tashmë nuk ka shqiptar që nuk e di se kush është ai, kjo gjë e tmerron dhe përpiqet të ndikojë sa të mundet, kë të mundet.

Për një njeri që ka patur primatin e kontrollit të narrativës publike, humbja e këtij primati është një tmerr i vërtetë.

#### **Për drejtësinë**

Ai u mundua edhe sot të ndërsejë drejtësinë atje ku do vetë, siç ka bërë deri më tani.

Tha se drejtësia ka marrë masë ekstreme për Vlorë Hysenin. Po t'i kujtojmë me radhë selektivitetin e deklaratave të Ramës për njerëzit e përzemërt dhe për ata që kishte plane t'i bënte koka turku. Pa llogarit këtu kundërshtarët politikë, s'po i marr fare në analizë urdhërat publike për arrestimin e tyre.

Për Saimir Tahirin tha: kërkesa e arrestimit është arbitrare dhe argumentoi se kërkohej arrestimi pa u marrë më parë në pyetje.

Pra, mbrojtje shumë e fortë personale dhe politike, ndërsa kundërshtoi edhe masën e kërkuar nga prokuroria.

Për Erion Veliajn kritikoi arrestimin dhe mënyrën e trajtimit të tij para një vendimi përfundimtar.

Për Belinda Ballukun, Edi Rama kaloi edhe më hapur në mbrojtje institucionale e politike. Për pezullimin e saj nga detyra tha: "një absurditet të rrezikshëm."

Pra, Ballukun Rama e mbrojt kryesisht duke sulmuar dhe vënë në pikëpyetje mënyrën dhe kompetencat me të cilat po vepron drejtësia.

Për Vlorë Hysenin e thamë, e quajti masë ekstreme.

Ndërsa për Arben Ahmetajn pati një dallim të madh. Rama ka përdorur një gjuhë shumë agresive ndaj Ahmetajt, përfshirë frazën: "Po të isha unë prokuror, gjërat do të ishin shumë më keq."

I solla këto raste për të ilustruar orientimin, ose ndërsimin që e quaj unë, që Rama i bën drejtësisë.

Dhe frika e fundit e Edi Ramës, të cilën nuk e fshehu dot në gurgullimën e fjalëve gjatë monologut të vogël në Rinas është agonia.

Ai e ndien se "profecia" e tij, "skeni parë gjë akoma" do të përmbushet pikërisht me të. Se ajo çfarë do të shohin shqiptarët në vijim do të jetë hiçgjë me çfarë kanë parë deri tani për Edi Ramën.

Kështu u mundua që të shkruajë një epitaf, me shpresën që të përdoret ai që po le amanet vetë dhe jo ai që pritet t'i vendoset jetës së tij politike 28 vjeçare në pushtet nga drejtësia dhe historianët.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Skandali i SHISH/ Muçollari: Rama do që krimi të mos merret vesh, jo që të mos ndodhë



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!



Protesta e 120-të kundër Ramës, qytetarët marshojnë nga Sheshi Skënderbeu deri Kruamincicë

'Garancia e plotë' e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlorë Hysenin



Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së



'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht



## TË NGJASHME



Droga po shkon tek fëmijët tanë!



VIDEO/ Brahaj: OKB-ja u kthye në skenë shou, liderët luajtën secili për vete, problemet mbetën aty



120 ditë protestë/ Qytetarët nuk ndalen në Tiranë, sot kërkojnë sërish dorëheqjen e Edi Ramës



'Në emër të Këshillit Bashkiak, por firmat janë të PS'/ Alimehmeti: Rama e futi Veliajn në burg, Rama e mban



Rama anuloi konferencën, Noka: Duhej të jepte llogari për emërimet e tij, iu tremb pyetjeve për SHISH-in dhe Vlora Hysenin



SYRI TV/ Skandali i SHISH, Rama largon përgjegjësinë nga vetja: Përgjegjësia është individuale



VIDEO/ Mal Berisha-Ramës: Të quash Biden tradhtar është fyese, ai është një nga mbështetësit më të mëdhenj të Kosovës

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MUZIKË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione [info@syri.net](mailto:info@syri.net), për reklama [marketing@syri.net](mailto:marketing@syri.net)